



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

PROGRAMI I LËNDËS
Drejtimi : Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore

TITULLI I LËNDËS: HISTORIA E LETËRSISË SHQIPE

Pedagogu: Phd.c. Kastriot GJIKA
Ngarkesa: 4 ECTS (30 leksione dhe 15 seminare)
Lloji i lëndës: me zgjedhje
Programi i studimit: Bachelor
Viti/Semestri: II/I

EKSTRAKT

Kursi i letërsisë shqipe » është një lëndë që i shërben formimit të studentëve të drejtimit « Arkeologji dhe trashëgimi kulturore ». Kjo lëndë synon të njohë e të informojë studentët e këtij drejtimi me rrugën e gjatë e shumëshekullore që ka ndjekur letërsia shqipe parakombëtare e kombëtare, gjatë procesit të vështirë të lindjes, të zhvillimit e të formësimit të saj.

Paradigma e historisë së letërsisë shqipe ka pësuar procese e zhvillime që herë e afrojnë atë me letërsitë e tjera evropiane e herë e shkëpusin atë nga ky rrugëtim, duke i dhënë asaj një pamje « atipike ».

Studentët e këtij kursi do të kenë mundësinë të njohin një nga aspektet më me peshë të trashëgimisë jomateriale të popullit shqiptar, një nga ato vlera që nga njëra anë ka ndikuar në formësimin e kombit tonë e nga ana tjetër, shërben si një dëshmi e qartë dhe një provë e sigurtë e autenticitetit dhe unicitetit të tij.

I konceptuar edhe si një kurs historik, kjo lëndë do të trajtojë çështje që lidhen më periodizimin dhe historicizimin e fenomeneve letrare, duke i parë ato edhe në kontekste më të përgjithshme historike, qoftë të historisë së popullit tonë, qoftë edhe të historisë së përgjithshme.

TEMAT:

LEKSION 1. Çështja e periodizimit të letërsisë shqipe. Periodizimi alternativ sipas teorisë së qarqeve kulturo-religjioze.

LEKSION 2. Fillimet e letërsisë shqipe. Shkrimtarë shqiptarë të humanizmit (që shkruan në latinisht)

LEKSION 3. Letërsia shqipe filobiblike. Buzuku, Budi, Bogdani, Bardhi

LEKSION 4. Letërsia shqipe përgjatë Mesjetës

LEKSION 5. Letërsia arbëreshe: vatra qendrore e lindjes së letërsisë sonë kombëtare

LEKSION 6. Letërsia shqiptare e Rilindjes Kombëtare. Romantizmi shqiptar dhe përfaqësuesit e tij

LEKSION 7. Naim Frashëri dhe letërsia e tij

LEKSION 8. Letërsia shqiptare e gjysmës së parë të shekullit të XX. Karakteristika dhe tipare të saj

LEKSION 9. Gjergj Fishta dhe letërsia e tij

LEKSION 10. Migjeni – fenomen letrar i periudhës së paraLuftës

LEKSION 11. Letërsia shqiptare e pasLuftës së Dytë Botërore. Letërsia e “realizmit socialist” në Shqipëri

LEKSION 12. Letërsia e Ismail Kadaresë brenda dhe jashtë sistemit letrar

LEKSION 13. Letërsia shqipe në Kosovë. Vepra letrare e Anton Pashkut

LEKSION 14. Letërsia e Martin Camaj dhe dukuritë letrare të diasporës shqiptare

LEKSION 15. Fenomene letrare të ditëve tona në kuadër të letërsisë shqipe

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT**FREKUENTIMI:**

75% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)
Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)
25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)
20 % e notës përfundimtare

KONTROLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit, pas kryerjes së 15 javëve të një semestri
40 % e notës përfundimtare

DETYRIMET E STUDENËVE PËR LËNDËN

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjesshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të smestrit)

LITERATURA:

1. ROBERT ELSIE, *Histori e letërsisë shqiptare*, (përkthyer nga Abdurrahman Myftiu), Dukagjini; Tirana, Peja, 1997
2. REXHEP QOSJA, *Shkrimtarë dhe periudha*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2005.
3. ALI XHIKU, *Letërsia shqiptare si polifoni*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2004
4. SABRI HAMITI, *Albanizma*. A.Sh.A.K, Prishtinë, 2009